


Rafik Schami

Babai im
nuk ka më frikë
nga të huajt



Ilustruar nga Ole Könnecke

Letërsi e huaj për fëmijë
Rafik Schami
Ilustruar nga Ole Könnecke
Babai im nuk ka më frikë nga të huajt
DITURIA

Rafik Schami

Babai im
nuk ka më frikë
nga të huajt

Ilustruar nga Ole Könnecke



Përktheu: Greisa Ymeri Boehl

Shtëpia Botuese DITURIA

Titulli original:
Rafik Schami · Ole Könnecke
Wie ich Papa die Angst vor Fremden nahm

Redaktore: Mariana Ymeri
Paraqitja grafike: Ulinda Selenica

© 2003 Carl Hanser Verlag GmbH & Co. KG, München
© Copyright për botimin shqip, DITURIA, 2023



Ky projekt është realizuar me mbështetjen financiare të Komisionit European. Ky botim pasqyron vetëm pikëpamjet e autorit dhe Komisioni nuk mund të konsiderohet përgjegjës për përdorimet e mundshme të informacioneve që përmban teksti.

Shtëpia Botuese DITURIA
Rruga "Frederik Shiroka", Nr. 31, Tiranë
P.O. Box 1441
Tel.: + 355 4 2236 635; Cel.: + 355 692048503
E-mail: sekretaria@dituria.al
www.dituria.al
Shtëpia Botuese DITURIA



Do t'ju rrëfej një ngjarje,
që as unë vetë s'po e besoj dot.




Babai im është i gjatë,



i fortë



dhe i mençur.



Kurrë nuk e humb
durimin.

Dhe më shkrin së qeshuri.



Shkurt, ai është heroi im. Që kur mamaja nuk është
më, ai jeton vetëm për mua.



Është madje edhe prestidigjitor i zoti. I qan lojërat e shpejtësisë.



Për më tepër, nuk i bën syri tërr.

Por një gjëje i trembej, dikur. Të huajve, sidomos atyre që e kishin lëkurën të zezë. Jo se ai më kishte folur ndonjëherë, por unë e kisha kuptuar vetiu. Nëse në rrugë shkëmbeheshim me një njeri me lëkurë me ngjyrë, babai ma shtrëngonte aq fort dorën, sa dukej sikur do të ma shkërmoqte. Njëherë ishim në ashensor. Kur hyri një zotëri i zi dhe i shëndoshë, pashë që babait po i binin djersët palë-palë. Zgurdullova sytë, këtë nuk e pritja kurrë prej tij.

- Baba, çfarë po të ndodh?- e pyeta.

- Asgjë, por të zinj të më fusin frikën,- u përgjigj.

